



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 14

Prishtinë, më 19 prill 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Ramadan Gashi, Adem Salihaj, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Selvije Halimi, Radmila Vujoviq dhe Mufera Şinik.

Mungoi: Kolë Berisha.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Genc Nixha dhe Metije Ademi – ekspertë të angazhuar nga Komisioni, Bedri Bahtiri – MD, Vlora Marmullakaj – EULEX, Shqipe Arifaj – Asociacioni i Komunave të Kosovës, Lumnije Murati – ZPRK, Floriana Shala – OSBE, Armend Atashi – Koha Ditore, Isuf Zejna – KDI, Albulena Ademi dhe Dafina Bardhi – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni, Sulltane Gashi dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 12 prillit 2010,
3. Shqyrtimi i Propozimamendamenteve të grupit të punës dhe të deputetit Riza Smaka, për Kodin e Drejtësisë për të Mitur,
4. Shqyrtimi i kërkesës së deputeti Naim Rustemi,
5. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media,
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 12 prillit 2010

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 12 prill 2010, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Propozimamendamenteve të grupit të punës dhe të deputetit Riza Smaka, për Kodin e Drejtësisë për të Mitur

Kryetari - I paraqiti për shqyrtim Propozimamendamentet e grupit të punës dhe të deputetit Riza Smaka, për Projektkodin e Drejtësisë për të Mitur. Theksoi se jemi brenda afatit të paraparë për procedim dhe grupi punues ka paraqitur amendamentet për miratim në Komision.

Adem Hajdaraj - Propozoi që amendamenti 1 i grupit punues të jetë: “ *Në tërë tekstin e Projektkodit të Drejtësisë për të Mitur, në vend të fjalës “ligj” të jetë fjala “kod”*”.

Ramadan Gashi - Kërkoj të sqarohet fjala “shqipton” dhe “cakton”, sepse edhe në ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale është debatuar dhe është lënë si mundësi të diskutohet. Ishim të mendimit që në vend të fjalës “shqipton” të jetë “cakton”.

Armend Zemaj - U pajtua me parafolësin duke sqaruar se edhe kodi penal i Shqipërisë e njeh këtë terminologji, që në vend të fjalës “shqipton” të jetë “cakton”, kjo do të ishte mirë të jetë edhe në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale.

Sqarime rreth fjalës “shqipton” dhe “cakton” dhanë edhe Metije Ademi, Bedri Bahtiri dhe Genc Nixha, me sqarimet e dhëna teksti mbetet si në P/L.

Adem Hajdaraj dhe Armend Zemaj ishin për amendamentin e deputetit Riza Smaka, si vijon: “*Kodi i Drejtësisë për të Mitur (në vijim: Kodi) rregullon mënyrën e caktimit, të ekzekutimit të masave dhe të dënimeve, procedurën gjyqësore dhe procedurën e ndërmjetësimit për të miturit*”.

Ibrahim Makolli - Propozoi që neni 3.2 të jetë: “ *Kryerësve të mitur u shqiptohen masat e diversitetit dhe masat edukative sipas nevojës*”.

Duke ju referuar nenit 3.3 propozoi të riformulohet si vijon: “*Privimi nga liria shqiptohet vetëm si mjet i fundit dhe do të kufizohet në afatin më të shkurtër të mundshëm. Gjatë kohës së privimit nga liria, i shqiptuar si dënim, kryerësit të mitur i ofrohet edukim, ndihmë psikologjike, e sipas nevojës edhe ndihmë mjekësore për të lehtësuar rehabilitimin e tij*”. Në vazhdim theksoi se në nenin 30. 2 numri “5000” duhet të mbetet si në P/L, dhe jo siç është propozuar nga grupi punues “2500”.

Armend Zemaj - Propozoi që neni 51 të riformulohet si vijon: “Gjykata e cila do të jetë kompetente në shkallë të parë për të gjitha çështjet penale që kanë të bëjnë me të miturit në territoret e disa gjykatave, caktohet sipas Ligjit mbi gjykatat”

Adem Hajdaraj - Duke ju referuar nenit 51 tha se duhet të mbetet si në P/L, me të vetmin ndryshim që në vend të “ *mund të caktojë*” të jetë “ *duhet të caktojë*” dhe riformulohet si vijon: Këshilli Gjyqësor i Kosovës *duhet* të caktojë një gjykatë, e cila do të jetë kompetente në shkallë të parë për të gjitha çështjet penale që kanë të bëjnë me të miturit në territoret e disa gjykatave.

Ishte i diskutueshëm amendamenti 9 i grupit të punës i riformuluar si vijon: “*Këshilli Gjyqësor i Kosovës cakton gjykatën e cila do të jetë kompetente në shkallë të parë për të gjitha çështjet penale që kanë të bëjnë me të miturit në territoret e disa gjykatave*”. Diskutuan: Adem Salihaj e Ibrahim Makolli, ndërsa me propozimin e Bajram Kosumit dhe me arsyetimet e dhëna nga ekspertët, ishte konstatim i përgjithshëm që ky nen të hiqet.

Armend Zemaj - Duke ju referuar nenit 69.1 tha se grupi punues i cili është duke punuar në P/L për ekzekutimin e sanksioneve penale ka vendosur që në ato nene ku i referohemi kodit penal dhe kodit të procedurës penale, me një amendament të thuhet: “Në pajtim me dispozitat e kodit penal dhe kodit të procedurës penale” duke ju shmangur referimeve në nenet përkatëse pasi edhe kodi penal edhe kodi procedurës janë në procedurë për ndryshim dhe plotësim, prandaj do të ndryshojnë edhe nenet.

Selviqe Halimi - U pajtua me parafolësin që me një amendament të parashihet që në tërë Projektligjin ku i referohet neneve të caktuara të kodit penal dhe të kodit të procedurës penale të fshihen dhe të thirren vetëm në dispozitat e kodit penal dhe kodit të procedurës penale.

Kryetari - Propozoi që neni 69.1 të riformulohet si vijon: “*Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës zbatohen përshtatshmërisht për paraburgimin ndaj të miturve*”. Në vazhdim të shtohet një paragraf i ri si: “ *Përgjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni i mituri nuk mund të mbahet në paraburgim më shumë se 12 muaj nga dita e arrestimit*”.

Kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

PËRFUNDIM

Miratohen amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në Projektkodin e Drejtësisë për të Mitur, të njëjtat procedohen për shqyrtim të mëtejshëm.

Komisioni përkrahu amendamentin 5 të deputetit Riza Smaka, si vijon:
Neni 15

“Ndërmjetësuesi është person fizik që i përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara me Ligjin për Ndërmjetësimin dhe është i regjistruar në Regjistrin e Ndërmjetësuesve”

Komisioni nuk i përkrahu Amendamentet 1,2,3,4,6, dhe 7 të deputetit Riza Smaka.

4. Shqyrtimi i kërkesës së deputeti Naim Rrustemi

Kryetari - I njoftoi me mocionin e deputetit Naim Rrustemi, i cili ka kërkuar nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi që në seancën e parë plenare të Kuvendit ta paraqesë rekomandimin e tij lidhur me shkeljen eventuale të Rregullores së punës së Kuvendit nga ana e Kryetarit të Kuvendit. Ftoi anëtarët ta japin mendimin rreth kësaj çështje.

Adem Salihaj - Në fjalën e tij tha se në vazhdimin e seancës, ku është dashur të miratohen rekomandimet, kryetari i ka lejuar të diskutojnë vetëm shefat e grupeve parlamentare, por nuk i ka lejuar deputetët, ankesa e tij është e arsyeshme, sepse ka pasur të drejtë si deputet që të diskutojë për këto rekomandime. Ishte i mendimit që deputeti Naim Rrustemi ka pasur të drejtë të diskutojë për rekomandimet.

Selviqe Halimi - Theksoi se në seancën kur është diskutuar për strategjinë deputetët kanë zhvilluar debatin për bazën e strategjisë dhe për bazën e rekomandime të Komisionit FunkSIONAL, kjo seancë ka përfunduar pa ndonjë konsensus. Në përfundim të debatit kryetari i Kuvendit ka propozuar që Komisioni FunkSIONAL, së bashku me përfaqësuesit e G/P dhe ekspertët të hartojnë rekomandime që do t'i bashkëngjiten strategjisë dhe ato të votohen në seancën e radhës. Në vazhdim ceku se në seancën e radhës kur Komisioni FunkSIONAL ka sjellë rekomandimet në Kuvend, ku është kërkuar nga G/P të japin mendimin pro strategjisë ose pro rekomandimeve. Secili G/P e ka dhënë mendimin, ndërsa deputetët që janë të pavarur mbesin jashtë kësaj të drejte. Konsideron se nuk është shkelur Rregullorja e punës së Kuvendit.

Armend Zemaj - Duke u ndërlidhur me parafolësit tha se problem është Rregullorja e punës së Kuvendit, e cila nuk specifikon fjalën e deputeteve të pavarur.

Ibrahim Makolli - Theksoi se rregullorja e Kuvendit nuk ja ndalon deputetit të japë mendimin përkitazi me amendamentet, sepse thuhet në rregullore “ Kuvendi e shqyrton “ dhe Kuvendi përbëhet nga deputetët, sepse në lexim të dytë lejohet ndërhyrja për amendamentet.

Bajram Kosumi - Duke ju referuar transkriptit të seancës tha se sipas këtij transkripti është mbyllur debati nga Kryetari Kuvendit, ju është dhëna fjala shefave të G/P- së. Ky është një lëshim nga ana e kryetarit, sepse nëse ka përfunduar debati nuk është dashur t'u jepet fjala shefave të G/P -së.

Ramadan Gashi - Ishte i mendimit se nuk është shkelur procedura, sepse me rregullore janë paraparë parimet e udhëheqjes së procedurave, por Kuvendi mund të bëjë shmangie nga parimet, dhe në këtë rast kemi shmangie. Kjo ngase Kryetari ka thënë të shkohet me shefat e G/P- së. Në vazhdim ceku se me rregullore deputeti i pavarur nuk barazohet me G/P - në.

Kryetari konstatoi se Komisioni, me gjashtë vota “për”, një “kundër” dhe një abstenim nxori këtë:

PËRFUNDIM

Komisioni ka vlerësuar se në seancën e 18 marsit 2010 të Kuvendit të Kosovës, ka përfunduar debati rreth Strategjisë për Energjinë për periudhën 2009 - 2018 dhe ka vendosur që Komisioni FunkSIONAL, në bashkëpunim me ekspertë të bëjë plotësime për strategjinë e cila do të votohej në seancën e ardhshme. Në seancën e 1 prillit, pasi ka marrë qëndrimet e shefave të grupeve parlamentare, Kuvendi e ka hedhur në votim këtë strategji.

5. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media,

Komisioni lidhur me kërkesën e Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, rekomandoi që të veprohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Interesit.

6. Të ndryshme

a. Shqyrtimi i bazës juridike të projektligjeve

Komisioni e shqyrtoi bazën juridike të projektligjeve:
Projektligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës,
Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Ujitjen e Tokave Bujqësore,
Projektligjit për Grevat dhe
Projektligji për Energjinë Elektrike.

Komisioni vlerësoi se projektligjet kanë bazë juridike në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

b. Njoftim rreth vizitës në Shqipëri

Kryetari duke i njoftuar me agjendën e paraparë tha se Komisioni do të udhëtojë në Shqipëri më 21. 04. 2010.

Mbledhja përfundoi në orën 15: 30

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni